

VENDIM
Nr. 223, datë 10.7.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË
LIDHJE ME TRANSFERIMIN E PJESSHËM DHE MODIFIKIMIN E PJESSHËM TË
LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, VETËM PËR HEC-in
ZALLI I BULQIZËS, NGA SHOQËRIA “TEODORI 2003” SHPK TE SHOQËRIA
“KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1202/34 prot, datë 6.7.2023, të drejtorive teknike të ERE-s “Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria ‘Teodori 2003’ sh.p.k. te shoqëria ‘Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin 161, datë 9.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, me kapacitet të instaluar 5.350 MW.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.5.2023 dhe 12.5.2023). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palë të treta, janë paraqitur në ERE objeksione ndaj këtij vendimi, nga palët e interesuara.

- Në zbatim të nenit 10, pika 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ERE me shkresën nr. 1202/28 prot., datë 21.6.2023, i dërgoi shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. objeksionet si më sipër, duke i kërkuar të paraqesë shpjegimet përkatëse për secilin prej tyre.

- Me qëllim sqarimin e të gjitha objeksioneve dhe kërkesave të depozituara në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 9.5.2023, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua në ambientet e ERE-s më datë 3.7.2023, mes përfaqësuesve të ERE-s, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërisë “Teodori” sh.p.k., shoqërisë “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., Bankës “OTP Albania Bank” sh.a. dhe znj. SH.N, aksionere e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k..

- Për gjithë sa më sipër, për të analizuar të gjitha objeksionet, sqarimet e dhëna nga aplikuesi mbi këto objeksione, e po ashtu, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve që palët paraqitën në këtë seancë apo depozitim të dokumentacionit në vijim të seancës së mbajtur, çka mund të sjellë nevojën e zhvillimit të një korrespondence të mëtejshme dhe/ose seance dëgjimore, vlerësojmë zgjatjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërinë “Teodori” sh.p.k., shoqërinë “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., Bankën “OTP Albania Bank” sh.a. dhe palët e interesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti